



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr.15929 Prot.

Lezhë, më 26.09.2022

**SHPLLJE PËR PRANIMIN NË NIVELIN BAZË NË SHËRBIMIN E
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN.**

Në zbatim të Ligjit Nr 152, datë 21. 12. 2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, V.K.M.-së Nr. 520, datë 25.7.2019, “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Urdhërit nr.68 datë 21.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2022”, i ndryshuar, Bashkia Lezhë shpall vende të lira pune në Drejtorinë e MZZH-së , në nivelin bazë për pozicionet:

- 1- Zjarrëfikës, Shpëtues, Luftues,
- 2- Zjarrëfikës, Shpëtues, Luftues,
- 3- Drejtues automjeti/luftues,
- 4- Drejtues automjeti/luftues,
- 5- Punonjës informacioni.

1. Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës.

Shërbimi i M.Z.SH.-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mara për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut.

Personeli zjarrfikës, operues, luftues dhe drejtues automjetesh zjarrfikëse është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të M.Z.SH.-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës.

Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gatishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë dhe me kolegët e tij.

1.1 Kërkesat e përgjithshme për pranimin.

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë);
- ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të M.Z.SH.-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm;
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm;
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë;
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- k) Kandidati për personelin drejtues automjetesh zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e M.Z.SH.-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi "D", si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor.
- l) Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrik etj.

1.2 Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e M.Z.SH.-së;
2. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
3. Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit,
4. Çertifikatë familjare;
5. Jetëshkrimi i plotësuar (CV)
6. Fotokopje dëftese pjekurie;
7. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjendje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar";
8. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
9. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
10. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti), Formular vetëdeklarimi;
11. Fotokopje të librezës së punës e njëzuar me origjinalin (nëse ka);
12. Çertifikatën që ka përfunduar me sukses testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
13. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
14. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "C";

15. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike;
16. 2 (dy) copë fotografi (2.5 x 3.5 cm).

Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përgjithshme të sipërcituara

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 10.10.2022, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë Lezhë.

1.3 Rezultatet për fazën e verifikimit.

Pas verifikimit të dokumentave, njësia e menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Lezhë do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të kërkuara më sipër. Kandidatët e kualifikuar në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohen në mënyrë elektronike, për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave të testimit dhe intervistës.

Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen në mënyrë elektronike, për arsyet e mos kualifikimit dhe kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Lezhë. Afati i ankimimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

Kandidatët e pa kualifikuar

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligjin nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- V.K.M.-ja nr. 520 datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

1.4 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e M.Z.SH.-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

Testi me shkrim hartohet nga strukturat e burimeve njerëzore të Bashkisë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të arsimit ose kompani të licensuara për këtë qëllim. Testi shërben për

të vlerësuar, nëse aplikanti zotëron njohurit dhe aftësit e nevojshme për të kryer detyrat e punonjësit të shërbimit të M.Z.SH.-së. Aplikantit i kërkohet të lexojë, të shkruajë, të analizojë dhe të kuptojë gjuhën standarte shqipe. Testi me shkim administrohet dhe vlerësohet me pike nga komisioni i testimit. Në përfundim të testit me shkrim, struktura e burimeve njërëzore publikon zyrtarisht listën e renditjes së rezultateve të testit. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike. Rezultatet e testit me shkrim ruhen në dosjen e aplikantit.

Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motorre, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të M.Z.SH.-së. Pikët maksimale të përcaktuara për këtë test janë 100. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit me gojë.

1.5 Rregullat dhe kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike janë si më poshtë:

a) Aplikanti duhet të paraqiten në datën e testimit me uniformë të rregullt sportive. Nuk janë të lejuara mjete të cilat mund të krijojnë avantazhe gjatë testimit. Nuk lejohet gjithashtu, përveç rasteve kur specifikohet nga mjeku, veshja e mjeteve si dorashka, rripa të trashë mesi, fashë elastike ose gjunjëza dhe varëse, të cilat mund të shkaktojnë dëmtim të individit gjatë testimit. Mjetet elektronike si MP3 player, radio, telefona celular apo bipera nuk janë të lejuara gjithashtu. Femrat duhet të heqin vathët gjatë zhvillimit të testit pasi kjo mund të shkaktojë dëmtim për ato.

b) Vendi i testimit duhet të jetë i sheshtë dhe të mos ketë pengesa të çdo lloji që mund të ndikojnë negativisht në formën sportive të aplikantit që testohet.

c) Aplikanti duhet të kalojë të gjitha fazat e testimit fizik në rendin e kërkuar.

Pas përfundimit të testit, kandidatit i bëhet i ditur rezultati dhe nëse ka kaluar njoftohet për të vazhduar procesin e testimit.

Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime. Aplikantët që kanë marrë 50% të pikëve të përcaktuara për testin, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit.

1.6 Qëllimet e intervistës me gojë dhe testi psikologjik konsistojnë në vlerësimin :

- a) Aftësitë e kandidatit për të menduar, analizuar, komunikuar dhe marrë vendime;
- b) Aftësitë e kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;
- c) Përshtatshërinë e kandidatit për të bërë punonjës i shërbimit të M.Z.SH.-së.

Zhvillimi i intervistës. Komisioni i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë i bën aplikantit pyetje të strukturuar, të cilat nuk kërkojnë njohuri paraprake të teknikave apo praktikave të shërbimit të M.Z.SH.-së. Pyetjet testojnë aftësitë e aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte dhe për të analizuar dhe marrë vendime.

Komisioni kryen intervistën me gojë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara dhe vendos për secilin aplikant rezultatin numerik, bazuar në një mekanizëm të miratuar vlerësimi.

Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal.

Për kontrollin psikologjik kandidatët e përzgjedhur i nënshtrohen kontrollit psikologjik, nga nje psikolog i licensuar, për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre nga pikëpamja psikologjike për të kryer detyra me rrezik të shtuar të shërbimit të M.Z.SH.-së.

1.7 Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 300 pikë.

Menaxhimi i procesit të konkurimit.

1. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të pranimi është Drejtoria e M.Z.SH.-së dhe njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë;
2. Struktura përgjegjëse për kryerjen e testimit me shkrim, testimit fizik, testimit psikologjik dhe intervistës me gojë është Drejtoria e M.Z.SH.-së së Bashkisë;
3. Struktura përgjegjëse për verifikimin përfundimtar të aplikantit është struktura e burimeve njerëzore të Bashkisë.

Kandidatët fitues do të renditen sipas numrit të pikëve të mara sipas rendit zbritës dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marë më shumë pikë.

Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Lezhë. Afati i ankimimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

KRYETARI
Pjerin Ndreu